REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr.06, datë 29.05.2023

## PËR
## MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "PARKU NATYROR "LIQENI I ULZËS" DHE ZONA E MBROJTUR PËRRETH TIJ", ME VENDNDODHJE NË BASHKITË MAT, MIRDITË DHE KURBIN

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Parku Natyror "Liqeni i Ulzës" dhe zona e mbrojtur përreth tij", me vendndodhje në Bashkitë Mat, Mirditë dhe Kurbin, me subjekt zhvillues Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT - KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**